



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 2268142; Fax 04 2268141

Nr. 533/10 Prot

Tiranë më 09.11.2015

V E N D I M

Nr. 123, datë 09.11.2015

“Për heqjen e masës së pezullimit dhe vazhdimin e hetimit administrativ për verifikimin e procesit të ristrukturimit, në Drejtorinë e Bujqësisë Tiranë”

Bazuar në urdhrin nr. 533/1 prot., datë 31.07.2015, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka nisur procesin e verifikimit të rastit të ***** dhe ***** , punonjës pranë Drejtorisë së Bujqësisë Tiranë, lidhur mbi transferimin e tyre nga Drejtoria e Bujqësisë Tiranë, tek Agjensia e Zhvillimit Bujqësor Rural, në kuadër të ristrukturimit dhe riorganizimit të institucionit. Në bazë të këtij urdhri ka nisur edhe verifikimi i rastit të dërguar me informacionin nr. 533/5 prot., datë 12.08.2015, për punonjës *****, i cili, ka pretenduar se është cënuar pa të drejtë nga procesi i ristrukturimit.

Në vijim, me shkresën nr. 3824/1, datë 20.08.2015, “*Kthim përgjigje tuajës nr. 533/4 prot., të datës 31.07.2015*”, Departamenti i Administratës Publike, ka njoftuar Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, se pasi ka administruar propozimin e Komisionit të Ristrukturimit të Drejtorisë së Bujqësisë Tiranë për transferimin e përhershëm të ***** , ***** dhe ***** , për shkak të ristrukturimit, ka konstatuar disa parregullsi në zbatimin e ligjit dhe ka filluar rishqyrtimin e procesit.

Për këtë arsye, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me vendimin nr. 91, datë 10.09.2015, ka vendosur pezullimin e procesit të verifikimit, deri në përfundimin e procedurës së rishqyrtimit nga ana e Departamentit të Administratës Publike.

Me aktin nr. 3898/1 prot., datë 29.09.2015, Departamenti i Administratës Publike ka njoftuar Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vendimmarrjen përfundimtare, lidhur me procesin e rishqyrtimit të ristrukturimit, në Drejtorinë e Bujqësisë Tiranë.

Sa më sipër, konstatohet se, shkak për të cilin është marrë masa e pezullimit me Vendimin nr. 91, datë 10.09.2015 “*Për pezullimin e procesit të verifikimit të rastit të ***** , ***** dhe ***** , punonjës pranë Drejtorisë së Bujqësisë Tiranë*”, tashmë nuk ekziston më.

Për këto arsye,

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në pikën 1, të nenit 11 dhe nenit 14, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17 datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Heqjen e masës së pezullimit dhe vazhdimin e hetimit administrativ për verifikimin e ligjshmërisë në procesin e ristrukturimit, në Drejtorinë e Bujqësisë Tiranë.
2. Zëvendësimin e z. Altin Shumeli (*aktualisht, Drejtor i Mbikëqyrjes*) me inspektorin Saimir Muçmataj, të cilit do t’i përcillen të gjitha materialet që lidhen me çështjen për vazhdimin e veprimeve të mëtejshme.
3. Inspektori, të përgatisë relacionin përkatës dhe ta paraqesë pranë Drejtorit të Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, brenda datës **25.11.2015**.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA